

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Nr. 611 / Prot, datë 17.06.2022
110

Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

DHE

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, i përfaqësuar nga Rektori në detyrë Prof. Dr Roland Zisi dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (Shqipëri), i përfaqësuar nga Rektori në detyrë Prof. Dr. Arben GJATA, në zbatim të kompetencave të tyre përkatëse, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumëanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

Neni 1

Bashkëpunimi ndërmjet të dy Universiteteve do të përfshijë (në varësi të marrëveshjes):

- Shkëmbimin e pedagogëve dhe kërkuesve shkencorë në kuadrin e veprimtarisë së mësimdhënies, hulumtimit dhe kërkimit shkencor;
- Shkëmbimin e studentëve në tri ciklet e studimit: Bachelor, Master, Specializim dhe Doktoratë;
- Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;



- d. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- e. Shkëmbimin e literaturës shkencore;
- f. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional.

Neni 2

Të dy Universitetet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-f) dhe ndjekja e zbatimit të Marrëveshjes, do të realizohet nga i ngarkuari i Rektorit nga secili Universitet.

Neni 3

Çdo Nen i kësaj Marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy Universiteteve.

Neni 4

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy Universitetet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej Universiteteve kërkon të zgjidhë këtë Marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 3 (tre) muaj përpara. Mosrinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Universiteti i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Kjo Marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën Shqipe. Pasi lexohet, firmosen nga Rektorët përkatës.


Vlorë, më datë 17/06/2022

REKTORI

I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",

VLORE

PROF. DR. ROLAND ZISI



Tiranë, më datë / / 2022

REKTORI

I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,

TIRANË

PROF. DR. ARBEN GJATA

